

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6939
E shtunë, 8 korrik 2023
Çmimi 0.40 €

ATK-ja rrit të hyrat për 68 milionë euro

FAQE 8



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KURTI - RAMA: MOSPAJTME POLITIKE A INATE PERSONALE?!

FAQE 3



Mospajtimet e dy udhëheqësve kulmuan më 6 korrik, kur kryeministri i Kosovës refuzoi ta takonte homologun nga Shqipëria, i cili qëndroi për vizitë zyrtare në

Prishtinë. Profetori i së Drejtës dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Universitetin e Prishtinës, Enver Hasani dhe profesori i Shkencës Politike në Universitetin Evropian të

Tiranës, Ervis Iljazaj, pajtohen se përplasjet ndërmjet Kurtit dhe Ramës nuk do të çojnë në ndonjë çarje serioze të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Shqipërisë

HOVENIERI: PRESIM QË KOSOVA T'I PËRMBUSHË IDEALET E DEKLARATËS SË PAVARËSISË SË SAJ

FAQE 4-5



KRASNIQI ME AMBASADORIN E SUEDISË: POZICIONI I PDK-së, MBAJTJA E ZGJEDHJEVE TË PARAKOHSHME

FAQE 7

AKTUALE



GJERMANIA SHQYRTON DËRGIMIN E TRUPAVE SHITESË NË KOSOVË

F. 3

LAJÇI: MOSTAKIMI KURTI - RAMA NUK SHKON NË INTERES TË KOSOVËS DHE TË SHQIPËRISË

F. 6

KURTI PRET NË TAKIM SHEFIN E RI TË EULEX-IT, TEMË DISKUTIMI SIGURIA NË VEND

F. 7

EKONOMI



KOMUNA E MITROVICËS BËN PAGESAT PËR FAMILJET E PREKURA NGA VËRSHIMET

F. 6

KEDS-I INVESTON 350 MIJË EURO NË GURBARDH TË MALISHEVËS

F. 8

SPORT



NDESHJET BALLKANI - LUDOGORETS DHE DUKAGJINI - EUROPA ZHVILLOHEN NË STADIUMIN 'FADIL VOKRRI'

F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Rama në Sarajevë: Duam t'i mbrojmë interesat e Kosovës përmes Procesit të Berlinit

SARAJEVË, 7 KORRIK - "Nuk është sekret që ne duam t'i mbrojmë interesat e Kosovës përmes Procesit të Berlinit dhe duam ta arrijmë lirinë e lëvizjes dhe mënyra më e mirë është përmes përdorimit të letërnjoftimeve", tha kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, në Sarajevë, pas takimit me kryetaren e Këshillit të Ministrave të Bosnjë-Hercegovinës, Borjana Krishto. "Shpresoj që Bosnjë-Hercegovina të nënshkruajë një marrëveshje të tillë sipas modelit të Serbisë. Në tetor në Tiranë ne duhet të kemi një qëndrim të përbashkët për të gjitha çështjet që na shqetësojnë dhe çështjet që janë ngritur dhe që na shqetësojnë të gjithëve së bashku", tha Rama. Entiteti i Republikës Sërpska në Asamblenë Kombëtare të Bosnjë-Hercegovinës më 27 qershor bllokoi miratimin e

marrëveshjes për lirinë e lëvizjes me letërnjoftime në Ballkanin Perëndimor. Kjo, rrjedhimisht, bllokoi vendosjen e regjimit pa viza ndërmjet BeH-së dhe Kosovës, ndonëse për këtë u dakord në nëntor të vitit 2022, me nënshkrimin e marrëveshjes për lëvizje të lirë në Ballkanin Perëndimor në kuadër të Procesit të Berlinit.

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, të premten vazhdoi turneun e tij në kryeqytetet e shteteve të Ballkanit Perëndimor, turne ky që, sipas Ramës, synon t'i informojë shtetet e rajonit për përgatitjet që po bën Shqipëria për ta pritur samitin e Procesit të Berlinit. Samiti i Procesit të Berlinit do të mbahet në Tiranë më 16 tetor, në të cilin, sipas kryeministrit shqiptar, do të bëhet bilanci i arritjeve të këtij procesi. Ndajësia e parë e Ramës të



premtën ishte në Bosnjë-Hercegovinë, ku kryeministri shqiptar u takua me kryetaren e Këshillit të Ministrave, Borjana Krishto.

Kryeministri Rama tha, po ashtu, se Shqipëria dëshiron ta forcojë bashkëpunimin me

Bosnjë-Hercegovinën dhe se po punojnë që të hapin Ambasadën e Shqipërisë në Bosnjë.

Krishto, ndërkaq, tha se me Ramën kanë diskutuar për "raportet e mira dhe miqësore" ndërmjet dy shteteve. "Ne nuk

kemi çështje të hapura. Ne vumë në theks bashkëpunimin rajonal dhe se vazhdojmë të jemi të përkushtuar në Procesin e Berlinit", tha Krishto.

Pas kësaj vizite, Rama do ta vazhdojë udhëtimin për në Mal të Zi, ku do të zhvillojë takim, drekë pune dhe konferencë të përbashkët për medie me kryeministrin malazez Dritan Abazović. Ai do të takohet edhe me presidentin e Malit të Zi, Jakov Millatović.

Turneu i Ramës përfundon me vizitën në Serbi, ku do të takohet me kryeministrin serb Aleksandar Vučić. Në agjendën e kryeministrit shqiptar është paralajmëruar se bashkë me Vučićin do të mbajnë një konferencë të përbashkët për medie.

Një ditë më parë Edi Rama vizitoi Maqedoninë e Veriut dhe Kosovën.

Berlini kundër furnizimit të Kievit me municione thërrmuese

BERLIN, 7 KORRIK - Gjermania kundërshton që Ukrainës t'i dërgohen municione thërrmuese, tha ministrja e Jashtme gjermane, Annalena Baerbock, më 7 korrik. Ky reagim i Berlinit vjen një ditë pasi zyrtarët amerikanë thanë se Uashingtoni po planifikon ta furnizojë Kievin me municione të tilla.

Edhe organizatat e të drejtave të njeriut kundërshtojnë dërgimin e municioneve të tilla.

Ministrja Baerbock tha se Gjermania, si pjesë e 111 shteteve që kanë nënshkruar Konventën për Municionet Thërrmuese, kundërshton



dërgimin e tyre në Ukrainë.

Shtetet e Bashkuara nuk janë

pjesë e kësaj konvente.

E pyetur t'i komentojë deklaratat

e zyrtarëve në Uashington, Baerbock u tha gazetarëve se "kam përcjell raportimet e medieve. Për ne, konventa për marrëveshjen e Oslos ende vlen". Baerbock iu referua Konventës për Municione Thërrmuese që u nënshkrua në kryeqytetin norvegjez më 2008. Kjo konventë ndalon përdorimin, ruajtjen, prodhimin dhe transferimin e municioneve thërrmuese.

Shtëpia e Bardhë tha se çështja e dërgimit të municioneve thërrmuese në Ukrainë "po shqyrtohet".

Presidenti amerikan Joe Biden do të marrë pjesë në samitin e NATO-s javën

e ardhshme, që pritet të dominohet nga lufta në Ukrainë. Organizata Human Rights Watch u ka bërë thirrje Ruisë dhe Ukrainës ta ndalojnë përdorimin e municioneve thërrmuese dhe ka kërkuar nga ShBA-ja të mos e furnizojë Kievin me municione të tilla. Kjo organizatë tha se municionet thërrmuese janë përdorur si armë nga forcat ruse dhe ukrainase, të cilat kanë vrarë civilët ukrainas.

Municionet thërrmuese janë raketa dhe bomba që shpërthejnë në ajër mbi një objektiv dhe lëshojnë shumë pajisje të vogla shpërthyes.

Dodik nënshkruan ligjin për mospublikimin e vendimeve të Schmidtit

SARAJEVË, 7 KORRIK - Presidenti i entitetit të Republikës Sërpska, Millorad Dodik, ka nënshkruar ligjin kundërthënës sa iu përket vendimeve të përfaqësuesit të lartë në Bosnjë-Hercegovinë, njoftoi kabineti i tij. Sipas ligjit të dekretuar, vendimet e përfaqësuesit të lartë më nuk do të publikohen në këtë entitet. Dodik nënshkroi legjislacionin pavarësisht faktit që përfaqësuesi i lartë, Christian Schmidt, me vendimin e tij të 1 korrikut ka shfuqizuar të gjithë procedurën legjislative për këtë çështje.

Ligji u miratua nga Asambleja Kombëtare e Republikës

Sërpska në qershor. Përveç këtij ligji, Parlamenti i entitetit, po ashtu, ka miratuar një ligj që thotë se nuk do të zbatohen vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Bosnjë-Hercegovinës.

Zakonisht ligjet hyjnë në fuqi tetë ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare, por Parlamenti i entitetit ka votuar që ligjet të hyjnë në fuqi një ditë pas publikimit të tyre.

Klubi i Boshnjakëve në Këshillin e Popujve në Republikën Sërpska më 4 korrik tërhoqi veton ndaj dy legjislacioneve sepse, sipas vendimit të Schmidtit, këto "ligje më nuk

ekzistojnë".

Para nënshkrimit të dekretit, që i bën ligjet e plotfuqishme, ato duhet të miratohen nga Këshilli i Popujve, që është një mekanizëm për t'i mbrojtur interesat vitale kombëtare të etnive që jetojnë në Bosnjë: serbët, boshnjakët dhe kroatët. Dodik, një prej iniciatorëve të nismave kundërthënës ligjore, më herët ka thënë se entiteti i Republikës Sërpska nuk do t'i pranojë vendimet e Schmidtit.

Zyrtarët nga Republika Sërpska, të udhëhequr nga Dodiku, vazhdimisht kanë kontestuar legjitimitetin e Schmidtit qëkur ai e mori mandatin, pasi që



emërimi i tij në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara u kundërshtua nga Kina dhe Rusia.

Shtetet e tjera të Këshillit të

Sigurimit kanë thënë se nuk është e nevojshme që ky trup të votojë për emërimin e përfaqësuesit të lartë në Bosnjë-Hercegovinë.

Hovenier: Presim që Kosova t'i përmbushë idealet e Deklaratës së Pavarësisë

EPOKA ERE

MAL QORRAJ

PRISHTINË, 7 KORRIK - Në shënimin e Ditës së Pavarësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Ambasadën Amerikane në Prishtinë, ambasadori amerikan Jeffrey Hovenier e nisi fjalimin duke cituar një pjesë të Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës. Në këtë pjesë të deklaratës thuhet: "Kosova [shpallet] një Republikë demokratike, laike dhe multietnike, e udhëhequr nga parimet e jodiskriminimit dhe mbrojtjes së barabartë sipas ligjit. Ne do të mbrojmë dhe promovojmë të drejtat e të gjitha komuniteteve në Kosovë dhe krijojmë kushtet e nevojshme për pjesëmarrjen e tyre efektive në proceset politike dhe vendimmarrëse". "Ky tekst elokuent është pjesë e premimit të Kosovës dhe bazë e pavarësisë së saj", ka thënë Hovenier. Megjithatë, tha ai, "shpresoj se mund të pajtohemi që ndonjëherë Kosova nuk i ka përmbushur premtimet e këtyre idealeve". Ai ka thënë se Shtetet e Bashkuara janë krenare për mbështetjen që i kanë dhënë popullit të Kosovës në konceptimin, më pas realizimin e vizionit të pavarësisë së saj, dhe se do të mbetet e palëkundur për ta vazhduar këtë mbështetje. "Në këtë frymë dua të pohoj se Shtetet e Bashkuara dhe partnerët tanë qëndrojnë përkrah popullit të Kosovës në avancimin dhe arritjen e vizionit të saj themelues: shtetin demokratik, sovran, laik, multietnik", ka deklaruar Hovenier. Ambasadori theksoi se ShBA-ja dhe partnerët perëndimorë e mbështetin Kosovën duke ofruar këshilla, edhe pse kërkojnë "gjëra që duken ose janë vërtet të vështira për t'u bërë", por se këtë e bëjnë në përputhje me "përkushtimin afatgjatë për ta



mbështetur popullin e Kosovës dhe për t'iu afuar atyre idealeve shumë ambicioze që ata kanë krijuar për veten e tyre". "Kështu që sot, teksa ne festojmë 247-vjetorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës si një shtet i lirë, sovran, i pavarur, ne gjithashtu duam të festojmë së bashku, pasi Kosova arriti pavarësinë e saj të merituar; përparimin e jashtëzakonshëm që populli i Kosovës ka bërë në këtë periudhë të shkurtër kohore, dhe premtimin për përparim të mëtejshëm në dobi të të gjithë

popullit të Kosovës", u shpreh ai. Fjalimi i ambasadorit amerikan në këtë frymë vjen në kohën kur raportet në mes të Kosovës dhe partnerëve të tjerë ndërkombëtarë janë në një pikë të ulët. Kjo çarje ndodhi si pasojë e tensioneve në veri të Kosovës, i cili është i banuar me shumicë serbe, që u shkaktuan kur kryetari i ri shqiptar i Zveçanit, i Zubin Potokut dhe i Leposaviqit hynë në ndërtesat komunale nën përcjelljen e Policisë së Kosovës.

Serbët e kundërshtuan këtë dhe

që atëherë po zhvillojnë protesta duke kërkuar tërheqjen e kryetarëve të rinj dhe të njësive speciale policore. Bashkësia ndërkombëtare ka kërkuar nga Kosova dhe Serbia të ndërmarrin hapa për uljen e menjëhershme të tensioneve dhe në veri të mbahen zgjedhje të reja lokale. Presidentja Vjosa Osmani, e cila ishte e pranishme në këtë manifestim, ka thënë se "krahas aleatëve tanë amerikanë, festuam jo vetëm Ditën e Pavarësisë së Shteteve të

Bashkuara, por edhe miqësinë tonë të përherëshme, partneritetin e palëkundur dhe raportet e veçanta në mes të popujve tanë". Edhe kryeministri Albin Kurti mori pjesë në shënimin e 247-vjetorit të Deklaratës së Pavarësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kurti e uroi ambasadorin amerikan Jeffrey Hovenier për 4 Korrikun, me dëshirat më të mira për kombin amerikan, aleatin e madh të Republikës së Kosovës.

Gjermania shqyrton dërgimin e trupave shtesë në Kosovë

PRISHTINË, 7 KORRIK - Gjermania mund të dërgojë trupa shtesë për ta përforcuar misionin paqeruajtës të NATO-s në Kosovë, KFOR, pas rritjes së tensioneve në veriun e Kosovës të banuar me shumicë serbe, deklaroi më 7 korrik ministri i Mbrojtjes së Gjermanisë, Boris Pistorius. "Pas kërkesës nga kolegja ime austriake Klaudia [Tanner], ne po shqyrtojmë nëse mund ta rritim pak angazhimin tonë brenda mandatit aktual [parlamentar] që t'i lehtësohet barra Austrisë", tha ai për gazetarët pas takimit me homologët e tij nga Austria dhe Zvicra në Bern. Pasi në fund të majit tensionet në



veri të Kosovës u rritën, NATO angazhoi 700 trupa shtesë në Kosovë, përveç 4 000 trupave që veçse janë të dislokuar në Kosovë. Aktualisht në kuadër të KFOR-it janë 70 trupa gjermane. Që nga fundi i majit serbët në Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok po kundërshtojnë që kryetarët e rinj shqiptarë të punojnë në ndërtesat komunale. Ata, po ashtu, po kërkojnë tërheqjen e njësive speciale të Policisë së Kosovës nga veriu. Që nga ajo kohë në veri janë shënuar disa incidente me shok-bomba dhe granata dore si dhe më 29 maj në Zveçan protestuesit serbë janë përleshur me

pjesëtarët e KFOR-it. Nga këto përleshje kanë mbetur të lënduar dhjetëra persona nga të dyja palët. Bashkimi Evropian ua ka paraqitur tri kërkesa Kosovës dhe Serbisë për të ulur tensionet. Për shkak të mospërmbushjes së tyre, BE-ja nga fundi i qershorit ka nisur t'i zbatojë disa masa ndëshkuese. Ambasada e Gjermanisë në Prishtinë më 6 korrik konfirmoi për Radion Evropa e Lirë se ka ndërprerë përkohësisht bashkëpunimin me Kosovën në disa fusha të caktuara shkak i mospërmbushjes së kërkesave të BE-së.



Kurti - Rama: Mospajtime politike a inate personale?!

Mospajtimet e dy udhëheqësve kulmuan më 6 korrik, kur kryeministri i Kosovës refuzoi ta takonte homologun nga Shqipëria, i cili qëndroi për vizitë zyrtare në Prishtinë. Profesori i së Drejtës dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Universitetin e Prishtinës, Enver Hasani dhe profesori i Shkencës Politike në Universitetin Evropian të Tiranës, Ervis Iljazaj, pajtohen se përplasjet ndërmjet Kurtit dhe Ramës nuk do të çojnë në ndonjë çarje serioze të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Shqipërisë

PRISHTINË, 7 KORRIK - Përplasjet verbale në mes të kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, dhe atij të Shqipërisë, Edi Rama, kanë të bëjnë me çështje politike, por nuk përjashtohen as ato personale, thonë analistët. Mospajtimet e dy udhëheqësve kulmuan më 6 korrik, kur Kurti refuzoi ta takonte Ramën, i cili qëndroi për vizitë zyrtare në Prishtinë.

Një ditë më herët Kurti tha se me Ramën do të takojë vetëm në mbledhjen e qeverive të të dyja shteteve.

Një mbledhje e tillë, e planifikuar të mbahej më 14 qershor, nuk u mbajt, pasi Rama kërkoi t'i ndërrohej formati për shkak të tensioneve në veri të Kosovës.

Situata e sigurisë në këtë zonë të banuar me shumicë serbe u përkeqësua qysh në fund të majit, kur kryetarët shqiptarë të komunave atje hynë në zyrat e

tyre, me gjithë rezistencën e banorëve lokalë serbë.

Kurti nuk i përfilli kërkesat e komunitetit ndërkombëtar për tërheqjen e këtyre kryetarëve dhe organizimin e zgjedhjeve të reja. Mbledhja “nuk mund të mbahet në formatin e paraparë” dhe “nuk është momenti për të krijuar një pasqyrë të re me të asaj që, në fakt, ndodh në realitetin e Kosovës sot”, tha Rama muajin e kaluar.

Në një intervistë për televizionin “Klan Kosova” më 6 korrik, Rama tha se ka insistuar të takojë me Kurtin përpara mbledhjes së planifikuar të qeverive “për t’ia përcjellë disa shqetësime”, porse kjo nuk ka ndodhur. Sipas Kurtit, mbledhja e dy qeverive u anulua paarsyeshëm.

“Prandaj, unë e konsideroj të arsyeshme një mbledhje të përbashkët të të dyja qeverive,

por jo takime të tjera”, tha Kurti më 5 korrik.

Hasani: Rama perceptohet si ‘pykë’ e një pabesie

Profesori i së Drejtës dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Universitetin e Prishtinës, Enver Hasani, vlerëson se përplasjet Kurti - Rama ndodhin për arsye objektive dhe subjektive. E para, sipas tij, lidhet me raportin rajonal të forcave, si dhe me rolin dhe pozitën e Shqipërisë, si anëtare e NATO-s dhe si shtet i integruar në bashkësinë ndërkombëtare. Në këtë kontekst, thotë Hasani, Rama po përpigjet ta luajë rolin e një “hegjemoni” rajonal. Sipas tij, ai po përpigjet të ndërmjetësojë mes palës shqiptare dhe asaj

serbe, por edhe të paraqitet si “një gjysmëzëdhënës i bashkësisë ndërkombëtare, apo së paku i strukturave të sigurisë ndërkombëtare”.

Aspekti subjektiv, që ka acaruar marrëdhëniet mes dy kryeministrave, sipas Hasanit, është “takti me të cilin Rama i është qasur Kosovës jo vetëm tash, por edhe më herët”. Sipas tij, janë disa veprime të Ramës që janë perceptuar si të dëmshme nga Qeveria e Kosovës - nisur nga mbështetja e tij për idenë e ndryshimit të kufijve në mes të Kosovës dhe Serbisë, përpjekja për ta bindur Kosovën që t’i bashkohej nismës Ballkani i Hapur e deri te paraqitja e një draft-propozimi për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë. “Këto kanë lënë shije të keqe, sepse Rama është parë si një lloj ‘pykë’, e cila është pjesë e një pabesie më të madhe. Kështu është perceptimi i qeverisë aktuale, i qeverisë së Kurtit”, thotë Hasani. “Por, Rama, duke i përdorur faktorët objektive, në emër të të cilëve ai flet, po synon si shtesë një protagonizëm që, objektivisht, përveçse e delegjtimon Kurtin si pushtet, i

fryn edhe idesë së Kosovës si një shtet i dështuar ose në dështim e sipër. Kjo është esenca e problemit”, thotë Hasani për Radion Evropa e Lirë.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, i cili vjen nga Lëvizja Vetëvendosje e Kurtit, përmendi pikërisht tri momentet të cilave iu referohet edhe Hasani si arsye subjektive të përplasjeve Kurti - Rama. Ato “e kanë dëmtuar Kosovën”, tha Konjufca për mediet, pas takimit me Ramën. Rama, ndërkaq, Konjufcën e quajti “djalë simpantik”.

Iljazaj: Rama ka të drejtë, por e ekzagjeron me protagonizëm

Ervis Iljazaj, profesor i Shkencave Politike në Universitetin Evropian të Tiranës, thotë për Radion Evropa e Lirë se kryeministri i Shqipërisë, Rama, ka “sjellje paternaliste” ndaj autoriteteve të Kosovës, ngjashëm sikurse edhe kryeministrat e mëhershëm shqiptarë. Sipas Iljazajt, Rama ndjek një linjë politike që dallon nga ajo e Kurtit për sa iu përket çështjeve të Kosovës. Por, siç

Ymeri: Refuzimi i Kurtit për takim me Ramën, sjellje skandaloze fëmijërore

PRISHTINË, 7 KORRIK - Analisti politik Visar Ymeri e ka cilësuar skandaloz dh fëmijëror refuzimin e kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, të takohet me kryeministrin Edi Rama. Ai në "Debat Plus" tha se Rama ka ardhur në Kosovë për Procesin e Berlinit dhe se Kurti, edhe pse

ishte më i zëshmi nga liderët e Ballkanit Perëndimor për këtë proces, nuk pranoi të takohet me të. "Sjellja e sotme e Albin Kurtit, përveç skandaloze, është edhe fëmijërore. Sot Edi Rama ka ardhur së paku formalisht me një rol tjetër për Procesin e Berlinit... Erdhi në Kosovë, nuk

e takoi kryeministrin. Takimet nuk do të thotë se pajtohesh. Mirëpo, kryeministri i Kosovës ka qenë më i zëshmi pro Procesit të Berlinit, kundër Open Balkan. Tash nuk po e pret Ramën. Kë do ta presë prej Shqipërisë përpos Ramës?", ka thënë ai.

Ymeri tha se ata që e akuzojnë kryeministrin e Shqipërisë e bëjnë për shkak se në Shqipëri nuk ka liderë opozitarë që mund ta sfidojnë atë. Sipas tij, Kurti po përdoret në mënyrë që Rama të dobësohet politikisht në Shqipëri. "Nuk mendoj që figura e Albin Kurtit duhet të

përdoret në luftë ndaj Ramës. Kjo tregon për gjendjen politike të Shqipërisë, për ta luftuar Ramën, nuk ke lider në opozitë, duhet ta marrësh kryeministrin e Kosovës. Çfarë do të bësh? Ta bëni kryeministër të Shqipërisë, Albin Kurtin, nuk mundeni", ka thënë ai.



thotë ai, kjo nuk e justifikon faktin që ata të mos takohen.

Kurti, thotë Iljazaj, pretendon që Rama duhet t'i mbështesë qëndrimet e Qeverisë së Kosovës në sfidat që ka në veri me Serbinë, por edhe në raportet e krijuara me partnerët perëndimorë. Iljazaj konsideron se Shqipëria deri më tash, përmes politikës së Ramës, është sjellë si shtet neutral dhe jo si palë në konflikt. "Mendoj se Rama, në këtë çështjen e Kosovës, në këtë rast ka të drejtë. Pastaj, sigurisht se ai e ekzagjeron me protagonizmat e tij. Sigurisht që ka interesat e tij personale, të pushtetit të tij personal, për ta marrë rolin e protagonizmit në rajon, edhe me partnerët ndërkombëtarë. Kjo duket qartë", thotë Iljazaj. "Po, mesa duket, Albin Kurti këtë gjë nuk ia ka falur" qeverisë shqiptare dhe kryeministrit Rama sepse, ndoshta, ka pretenduar që Rama dhe qeveria shqiptare duhet ta ndjekin në politikën e tij", shton ai.

Prej kur datojnë mosmarrëveshjet?

Në verën e vitit 2018 mekanizma të ndryshëm shpërfaqën idenë e "korrigjimit" apo "përcaktimit" të kufijve ndërmjet Kosovës dhe

Serbisë si zgjidhje e mundshme për mosmarrëveshjet mes dy shteteve. Kurti asokohe e kritikoi Ramën për mbështetjen e kësaj ideje.

Në dhjetor të po atij viti Kurti mbështeti protestat e studentëve të universiteteve publike në Shqipëri, që kundërshtonin tarifën e larta të shkollimit dhe kërkonin cilësi më të lartë në arsim.

Më 10 tetor të vitit 2019, pastaj Serbia, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut miratuan një deklaratë që çoi drejt marrëveshjes për "Mini-Schengenin" ballkanik, e që më vonë u riemërua si "Ballkan i Hapur".

Kurti - asokohe kandidat për kryeministër të Kosovës - e kundërshtoi nismën, duke thënë se Rama ka bërë gabim në hapa. Sipas tij, nisma do të duhej të ishte e Kosovës dhe Shqipërisë, për të përfshirë më pas vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, krejt në fund edhe Serbinë.

Këtë nismë e kundërshtuam edhe udhëheqës të tjerë politikë në Kosovë.

Më 25 prill 2021, partia e Kurtit, Lëvizja Vetëvendosje, garoi në zgjedhjet e përgjithshme në Shqipëri, por mandatin e tretë si kryeministër i Shqipërisë e fitoi Rama.



Kurti dhe Rama i shprehën publikisht edhe mospajtimet për çështjen e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe për formimin e të cilit komuniteti ndërkombëtar insiston në vazhdimësi. Muajin e kaluar Rama tha se ka dorëzuar një propozim të draft-statutit të këtij asociacioni te zyrtarët e lartë të BE-së, si dhe te kancelari gjerman Olaf Scholz e te presidenti francez Emmanuel Macron, gjë që ngjalli pakënaqësi

te Kurti dhe autoritetet e tjera të Kosovës.

Po inate personale?

Profesori Hasani vlerëson se Qeveria e Kosovës aktualisht po vepron sipas logjikës së "arsyes shtetërore", për t'i mbrojtur ato që i konsideron "interesa shtetërore". Sjelljet e Ramës, "duke iu qasur Kosovës thujse nuk është shtet", i dëmtojnë këto interesa, thotë Hasani.

Megjithatë, ai nuk beson se mospajtimet e dy kryeministrave lidhen edhe me inate personale. "Jo, nuk janë shndërruar... Ato [inatet personale] kanë qenë të tejkaluara shumëfish dhe kanë pasur raporte shumë të përzemërta ideologjike. Dhe i kanë akoma. Unë pres që ata, në një moment, prapë të vijnë në pikën e njëjtë - edhe Kurti, por edhe Rama - sepse të dy janë të majtë të devotshëm", thotë Hasani.

Profesori Iljazaj mendon ndryshe. "Po t'i shikosh, që të dy janë politikanë me mbështetje të madhe, për momentin. Janë politikanë me karizëm të fortë që të dy. Kështu që, sigurisht, ka edhe një përplasje egosh, ka një garë protagonizmi të botës shqiptare të këtyre dy politikanëve", thotë ai. Hasani dhe Iljazaj pajtohen se përplasjet ndërmjet Kurtit dhe Ramës nuk do të çojnë në ndonjë çarje serioze të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Shqipërisë. "Unë dhe Albin Kurti kemi të njëjtin qëllim, qind për qind. Dallojmë tek ajo se si arrihet qëllimi", tha Rama më 6 korrik, duke komentuar dialogun për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi i cili tash për tash ka ngecur.

Filluan punimet për rehabilitimin e rrugës "Ismet Jashari - Kumanova"

PRIZREN, 7 KORRIK - Kanë filluar punimet për rehabilitimin e rrugës "Ismet Jashari - Kumanova" në Prizren. Lajmin e ka bërë me dije kryetari i kësaj komune, Shaqir Totaj. "Në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe qytetarët e

Prizrenit, punimet po kryhen me intensitet të lartë, në mënyrë që asfaltimi i shtresës finale të bëhet sa më shpejt", ka thënë ai. Totaj ka theksuar se rregullimi i këtij segmenti rrugor, shumë të frekuentuar, nga

rrethrotullimi të Spitali i Përgjithshëm i Prizrenit e deri në "Qafën e Kishës", ka qenë i domosdoshëm për banorët e disa lagjeve që i përshkon kjo rrugë, por edhe për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion që e përdorin këtë kalim.



Komuna e Mitrovicës bën pagesat për familjet e prekura nga vërshimet

MITROVICË, 7 KORRIK - Drejtorja e Financave, bazuar në propozimin e kryetarit të komunës, Bedri Hamza, dhe vendimin e Asamblesë Komonale për ndarjen e 2 500.00 eurove për ekonomitë familjare që kanë pësuar dëme si pasojë e vërshimeve të janarit në komunën e Mitrovicës, pas pranimit të listës nga komisioni,

sot ka bërë pagesën e mjeteve financiare në llogaritë bankare të përfituesve. Kryetari Hamza i ka njoftuar qytetarët që 186 familje kanë përfitur nga buxheti komunal në vlerë totale 465 000.00 euro, duke shprehur zotimin për përkujdesjen e mirëqenies së të gjithë qytetarëve të komunës së Mitrovicës.

Për dy muaj radhazi do të shfaqen filma në kinemanë verore në Podujevë

PODUJEVË, 7 KORRIK - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me drejtoreshën e Qendrës Kombëtare e Kinematografisë, Blerta Zeqiri, për kinemanë verore në Podujevë, duke shfaqur filmat e prodhuar nga QKK në disa prej

hapësirave publike në qytetin e Podujevës si në parkun e pishave, sheshin e qytetit dhe teatrin. Shfaqja e filmave do të bëhet për dy muaj radhazi nga një brenda javës. Kryetari Bulliqi e ka falënderuar drejtoreshën e QKK-së për mundësinë që po ofrojnë për

funksionalizimin e kinemasë verore, duke u mundësuar dashamirësve të filmit të shohin filma të ndryshëm të prodhuar nga QKK-ja. Në ceremoninë e nënshkrimit të memorandumit të bashkëpunimit ishte edhe drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport, Pajtim Balaj.



Kushtrim Kadriu zgjedhet kryesues i ri i Kuvendit të Gjilanit



GJILAN, 7 KORRIK - Kuvendi i Komunës i Gjilanit, me 20 vota për dhe asnjë kundër, ka zgjedhur të premtën, në një seancë të jashtëzakonshme, kryesuesin e ri, Kushtrim Kadriu (Vatra). Kadriu mori votat e partive opozitare në një seancë ku ishin të pranishëm 32 anëtarë të Kuvendit, ndërkaq në votim morën pjesë vetëm 20 prej tyre. Kundërkandidatë ishin Riad Elezi (LDK) dhe Suzana Selimi (PDK). Kryesuesi i deritashëm, Arianit Sadiku (LV), u shkarkua javën e


kaluar me 19 vota të opozitës (LDK, PDK, Vatra), pas prishjes së koalicionit LV - PDK. Kadriu, pasi u falënderua për besimin e dhënë, tha se prioritet i tij është rifunksionalizimi i Kuvendit dhe trupave të tij. "Për mua do të jetë nder që t'i shërbej komunës sonë dhe qytetarëve të saj", ka thënë Kushtrim Kadriu. Deri në zgjedhjen e kryesuesit të ri seancën e jashtëzakonshme e ka udhëhequr Ismajl Kurteshi (LV), anëtar i vjetër i Kuvendit.

Kamenicë, 38 biznese përfituese të grantit komunal

KAMENICË, 7 KORRIK - Janë shpërndarë grantet komunale për biznese për vitin 2023 në Kamenicë. "Me një buxhet të ndarë prej 100 mijë eurosh, për herë të parë në historinë e Kamenicës,

komuna ndan grante për bizneset lokale", ka thënë kryetari i komunës, Kadri Rahimaj. Prej bizneseve përfituese, 11 prej tyre janë biznese të reja Start up-e, kurse 27

ekzistuese. Më shumë se 40 vende të reja pune, dhe 60+ pajisje pune do të financohen. Ai ka shtuar se është i lumtur që komuna po ndihmon në nisim të reja dhe rimëkëmbje ekonomike lokale.



Artan Dërmaku zgjedhet rektor i Universitetit "Kadri Zeka"

GJILAN, 7 KORRIK - Këshilli Drejtues i Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan, në mbledhjen e mbajtur të enjten, me votim të fshehtë ka zgjedhur Artan Dërmakun rektor të universitetit për mandatin katërvjeçar.

Në këtë mbledhje është bërë intervistimi i kandidatëve që kanë aplikuar për pozitën e rektorit, me ç'rast kandidatët kanë pasur mundësinë ta shpalosin vizionin e tyre, objektivat dhe prioritetet për

periudhën 2023-2027 për zhvillimin e universitetit.

Kryesuesi i Këshillit Drejtues, Ilir Gjinolli, e uroi për detyrën rektorin e ri, duke i dëshiruar shëndet dhe suksese. "Sipas statutit të Universitetit të Gjilanit 'Kadri Zeka' dhe Rregullores së Këshillit Drejtues të UKZ-së, rektorin e zgjedh Këshilli Drejtues nga lista e kandidatëve të propozuar nga komisioni profesional, i zgjedhur nga Senati i Universitetit. Rektorin është zgjedhur duke marrë

shumicën e votave të anëtarëve të përgjithshëm në pajtim me dispozitat e këtij statuti", thuhet në komunikatë.

Me zgjedhjen e rektorit është përmbyllur gjithë procesi zgjedhor në UKZ.

Fillimisht studentët kanë zgjedhur përfaqësuesit e tyre, janë mbajtur zgjedhjet për këshillat e fakulteteve dhe, së fundi, është konstituuar edhe përbërja e re e senatit, anëtarët e të cilit do ta marrin mandatin më 1 tetor 2023.



Krasniqi me ambasadorin e Suedisë: Pozicioni i PDK-së, mbajtja e zgjedhjeve të parakohshme



EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 7 KORRIK - Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka pritur të premten në takim ambasadorin e Suedisë në Kosovë, Jonas Westerlund, me të cilin ka biseduar për situatën në vend dhe për marrëdhëniet me Suedinë. "Situaata e rëndë në të cilën ndodhet Kosova aktualisht dhe zbehja e raporteve me aleatët ndërkombëtarë, si pasojë e krizave të prodhuara nga kryeministri Albin Kurti, janë

qëndrimet që ia shpreha sot ambasadorit të Suedisë në Kosovë, Jonas Westerlund, të cilin e prita në selinë e Partisë Demokratike të Kosovës, me ç'rast diskutuam për zhvillimet politike në vend", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".

Ai ka theksuar se ambasadorit Westerlund ia ripërsëriti pozicionin e PDK-së për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare pasi, sipas Krasniqit, situata në Kosovë është jonormale, sidomos pas sanksioneve të vendosura nga Bashkimi

Evropian. "Atë e njoftova edhe për vendimet e tjera të marra në mbledhjen e Këshillit Drejtues të PDK-së, që janë pezullimi i komunikimit zyrtar me kryeministrin Albin Kurti dhe presidenten Vjosa Osmani dhe vendimi për të mos votuar në asnjë forum të Kuvendit të Kosovës për asnjë ligj, rezolutë, marrëveshje ndërkombëtare apo dokument tjetër. PDK-ja mbetet e përkushtuar për ruajtjen dhe forcimin e marrëdhënieve të mira me partnerët tanë ndërkombëtarë", ka shkruar Krasniqi.

Lajçi: Mostakimi Kurti - Rama nuk shkon në interes të Kosovës dhe të Shqipërisë



PRISHTINË, 7 KORRIK - Ish-deputeti i Kuvendit të Kosovës, Driton Lajçi, ishte mysafir në RTK 'Prime', në të cilin është diskutuar për zhvillimet e fundit politike në vend dhe për refuzimin e ftesës së kryeministrit Albin Kurti për ta pranuar në takim kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama. Rama dje u prit në takim nga presidentja Vjosa Osmani dhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca.

Lajçi ka thënë se mostakimi i kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, me kryeministrin e Shqipërisë, nuk është pamje e mirë. Sipas tij, kjo e jep një porosi jo të mirë për raportet

në mes të Shqipërisë dhe Kosovës.

Ai përmendi disa nga proceset që janë shumë të rëndësishme për të dyja vendet, siç janë Ballkani i Hapur, çështja e veriut, Samiti i NATO-s, Samiti i Berlinit dhe disa tema jashtëzakonisht të rëndësishme.

Sipas Lajçit, këto procese kërkojnë unifikim. "Në vend se ne të bëhemi gati dhe ta luajmë lojën në stadium, ne po zihemi në tribuna... si përfundim kjo nuk është një pamje e mirë dhe nuk shkon në interes të Kosovës dhe të Shqipërisë, as të faktorizimit të shqiptarëve në Ballkan", ka thënë Lajçi.

Kurti pret në takim shefin e ri të EULEX-it, temë diskutimi siguria në vend

PRISHTINË, 7 KORRIK - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka pritur në takim shefin e ri të Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit, EULEX, Giovanni Pietro Barbano, me rastin e fillimit të mandatit të tij. Duke e falënderuar për mikpritjen, Barbano e përgëzoi kryeministrin Kurti për progresin mbresëlënës ekonomik dhe demokratik

që ka shënuar Kosova. U bisedua për bashkëpunimin ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe institucioneve të rendit dhe sigurisë me misionin EULEX me qëllim të forcimit të sundimit të ligjit si dhe për zhvillimet në vend.

Kryeministri Kurti ka theksuar përkushtimin e qeverisë për shtet ligjor,

demokraci dhe mbrojtje të lirive dhe të drejtave të njeriut të të gjithë qytetarëve që jetojnë në Republikën e Kosovës.

Në takim ishte i pranishëm edhe ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Gazmend Hoxha dhe koloneli i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Ejup Maqedonci.



ATK-ja rrit të hyrat për 68 milionë euro

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

Prishtinë, 7 korrik - Drejtori ekzekutiv i Administratës Tatimore të Kosovës, Ilir Murtezaj, në një konferencë për medie ka shpalosur rezultatet nga aktivitetet e realizuara përgjatë periudhës janar-qershor 2023. "Jam këtu sot për të ndarë me ju rezultatet dhe sfidat e ATK-së. Konferenca për medie është një rast i rëndësishëm për t'i prezantuar përpjekjet dhe arritjet tona në këtë kohë të veçantë. Në fillim dua të theksoj se periudha janar-qershor 2023 ka qenë një periudhë e rëndësishme për Administratën Tatimore. Përkundër sfidave të mëdha që jemi përballur, kemi arritur t'i realizojmë objektivat e planifikuara", ka thënë Murtezaj.

Përmes kësaj konference u tha se një nga arritjet kryesore ka qenë rritja e efikasitetit dhe transparencës në procedurat tatimore.

Përmirësimi i teknologjisë dhe automatizimit ka lehtësuar shërbimet për tatimpaguesit dhe ka rritur nivelin e besimit në administratën tonë.

Përderisa drejtori Murtezaj ka theksuar se realizimi i të hyrave ka arritur të tejkalohet për 68 milionë euro në raport me vitin e kaluar, rritje reflekton rezultatit e reformave të ndërmarra në proceset kyçe të autoritetit tatimor.

Në totalin e mbledhjes së të hyrave shifrat kapin vlerën e 423.2 milionë euro.

Vite më parë nga tatimet Kosova radhitej brenda mesatares së vendeve të



Ballkanit Perëndimor, ndërsa tani, duke iu referuar reformave të zhvilluara dhe rritjes së inkasimit të të hyrave, bazuar në raportin e FMN-së dhe mekanizmave të tjerë ndërkombëtarë, Kosova konsiderohet lidere në Ballkanin Perëndimor.

Po në këtë konferencë për medie u fol se trajtimi i borxheve pozicionohet si një ndër prioritetet me rëndësi të veçantë për ATK-në e që, bazuar në efektet e dhëna nga reformat në mbledhjen e borxheve, është arritur të inkasohen 91.6 milionë euro.

Drejtori i ATK-së ka shtuar se fokusi karshi sektorëve me risk

tatimor është duke prodhuar rezultate, me theks te sektori i gastronomisë/hotelerisë, estradës, stilistëve të bukurisë, si dhe pjesës së punëtorëve të padeklaruar.

Referuar statistikave, gastronomia/hoteleria kanë rritur pagesat nga 6.1 milionë euro sa ishte në periudhën janar-qershor 2022, këtë vit për të njëjtën periudhë 7 milionë euro pagesa. Ndërsa tek estrada ka rritje të dyfishtë të pagesave nga mbi gjysmë milioni euro pagesa (periudha referuese), këtë vit 1.2 milion euro.

Projekti i përbushjes tatimore "Personat e pasur", si

dhe "Mosdeklarimi i të ardhurave në TAP" ishin më të rejtat e fundit që u prezantuan, si planifikime të ATK-së, të cilat kanë për qëllim identifikimin e personave të pasur duke përdorur bazë të të dhënave në formë sistemi/platforme e cila mundëson ndërlidhjen me institucione qeveritare, joqeveritare, financiare me qëllim të trajtimit tatimor të kësaj kategorie, rritjen e numrit të deklarimeve dhe pagesës së tatimit nga kjo kategori e tatimpaguesve, si dhe zvogëlimin e hendekut tatimor si rezultat i mosdeklarimit të të ardhurave nga personat me të ardhura të

larta.

Në fund të kësaj konference drejtori Murtezaj ka falënderuar ekipin e ATK-së për punën e palodhshme për ta luftuar evazionin fiskal, ku u tha se përmes strategjive të reja kanë arritur ta zvogëlojnë evazionin dhe ta rritin mbledhjen e të ardhurave për buxhetin e shtetit. Ai tha se është e rëndësishme të përmendim se sfidat janë ende të mëdha. Sipas Murtezajt, Administrata Tatimore e Kosovës po përballet me kompleksitetin e ligjeve tatimore dhe nevojën për ndryshime dhe përmirësime të vazhdueshme.

KEDS-i investon 350 mijë euro në Gurbardh të Malishevës

MALISHEVË, 7 KORRIK - KEDS-i po vazhdon projektet anembanë Kosovës. Së fundi është realizuar projekti i eliminimit të rrjetit të vjetër elektrik dhe i vendosjes së rrjetit të ri në fshatin Gurbardh të Malishevës.

Korab Zymeri, inxhinier në KEDS dhe mbikëqyrës i këtij projekti, flet për vështirësitë që banorët e këtij fshati i kanë pasur me furnizim me energji elektrike dhe stabilitetin në furnizim dhe siguri që ua ofron rrjeti i ri energjetik. "Rrjeti ka qenë i vjetër! Ai ka kaluar përgjatë maleve e livadheve të banorëve. Shpeshherë ekupeve të KEDS-it u ka krijuar edhe vështirësi në mirëmbajtje për shkak të qasjes së vështirë me makineri", thotë ai. Ai thekson se rrjeti i ri tashmë është instaluar përgjatë rrugës kryesore të fshatit Gurbardh, duke shtuar se



"me instalimin e këtij rrjeti, konsumatorët tanë kanë siguri dhe furnizim stabil me energji elektrike".

Qazim Berisha, banor i këtij fshati, falënderon KEDS-in për instalimin e rrjetit të ri elektrik, duke i kujtuar se disa

dekada më parë, kur ai me vetëfinancim e kishte sjellë një pjesë të rrjetit elektrik deri te shtëpia ku banon. "Jemi

shumë të kënaqur me rrjetin e ri elektrik. Kjo është një punë e mrekullueshme dhe, mbi të gjitha, një punë që përkon me standarde të larta. Unë kam punuar një kohë të gjatë në Perëndim dhe e di saktë se si bëhet një punë sipas standardeve. Ky rrjet është njëri nga ato punë", u shpreh ai.

Projekti i Gurbardhit përkon me vendosjen e më shumë se treqind shtyllave të tensionit të mesëm dhe të ulët, afër 240 ormanëve, katër transformatorëve dhe dy trafo-shtyllave. Projekti kap një vlerë prej afër 350,000 eurosh dhe prej tij tashmë po përfitojnë më shumë se 1 000 banorë.

Në kuadër të këtij loti punimet janë duke vazhduar në linjën 10(20) kV Mirusha, prej të cilit projekt do të përfitojnë një numër i caktuar i konsumatorëve.

Misteri i ikonës britanike: I harruar gjatë jetës, mit pas vdekjes

Nga: Neil ARMSTRONG / BBC
Përkthimi (i pjesshëm) nga:
Telegrafi.com

Një makinë e hapur zbret nëpër rrugën e ndriçuar nga hëna kaliforniane; udhëtarët vështrojnë qiellin e mbushur me yje. Afrohen te një shtëpi në plazh ku po mbahet një festë e zhurmshme. Katër të rinjtë në kabriolet e shikojnë njëri-tjetrin dhe, duke u pajtuar në heshtje se nuk është për ta, vazhdojnë tutje.

Reklama e Volkswagenit e vitit 1999 është 60 sekonda e gjatë, por gati një çerek shekull më vonë shikuesit ende e postojnë në internet për ndikimin e thellë që ka – jo për shkak të pamjeve të bukura, por për shkak të muzikës që e shoqëron: kënga *Moon* nga Nick Drake.

Kantautori anglez vdiq në vitin 1974, në moshën vetëm 26-vjeçare. Ka publikuar tri albume që nuk bënë shumë bujë gjatë jetës së tij, por që gradualisht e krijuan një kult pas vdekjes së tij. Reklama amerikane e nxitë rritjen e interesimit për punën që ka lënë pas.

Dhe tani, pothuajse gjysmë shekulli pas vdekjes së tij, Drake sërish po rizbulohet. *The Endless Colored Ways*, një koleksion prej 23 këngëve të tij të interpretuara nga artistët si David Gray, Fontaines DC, Self Esteem dhe John Grant, do të lansohet këtë të premte, ndërsa biografinë e fundit sapo është publikuar – *Nick Drake: The Life*, nga Richard Morton Jack.

Biografia nuk e përmban asnjë zbulim të ri tronditës, asgjë që na i përmbyt në kokë ato që menduam se i dinim për të, por e ofron një portret të njeriut dhe milieut të tij përmes grumbullimit të detajeve interesante. Shërben gjithashtu për të korrigjuar shumë keqkuptime.

“Shumë supozime kanë lindur, sepse njerëzit priren t’i mitizojnë figura ikonike që vdesin të rinj”, tha Morton Jack për *BBC Culture*.

Autori intervistoi 200 njerëz nga të gjitha fushat e jetës së Nickut dhe iu dha qasja në dokumentet private të familjes së tij. Hulumtimi i tij sugjeron se, ndryshe nga sa besojnë disa, muzikanti nuk ishte i varur nga heroina; nuk ishte homoseksual; nuk është abuzuar në shkollë; dhe konflikti me të atin nuk ishte në themel të problemeve të tij.

“Ishin shumë detaje të vogla që munda t’i plotësoja”, thotë Morton Jack, i cili së fundmi e



vizitoi faqen e *Wikipedia*-s për Nickun dhe hoqi dorë nga numërimi i gabimeve faktike kur arriti në 50 sosh. “Kështu, për shembull, një nga të dhënat për të ka qenë se tymoste sasi të pabesueshme droge dhe se ishte dëmtuar plotësisht nga droga. Epo, askush që e njihte nuk e thotë këtë”.

Edhe pse Drake dha vetëm dy intervista për shtyp gjatë karrierës, elementet bazike për jetën e tij të shkurtër janë njohur prej kohësh. Nicholas Rodney Drake lindi më 19 qershor 1948 dhe u rrit në Uorikshër në një familje të dashur dhe muzikale. Kur shkoi në Universitetin e Kembrixhit më 1967, u përcaktua për karrierën muzikore.

Si kitarist i talentuar me një stil të veçantë, krijoi këngë delikate, ëndërrimtare dhe shpesh melankolike. Albumi i tij i parë, *Five Leaves Left*, u publikua më 4 korrik 1969, disa muaj para se ta linte universitetin. Shtypi muzikor u dominua nga lajmet për vdekjen e Brian Jonesit më 3 korrik dhe nga koncerti i grupit Rolling Stones në Hajd Park – dy ditë më vonë. Nuk kishte asnjë singël nga albumi dhe pothuajse asgjë në rrugën e promovimit, përveç një sesioni natën vonë për një program artistik të *Radios 2*, të prezantuar nga John Peel. Albumi tërhoqi pak vëmendje dhe pak u shit.

E njëjta histori u përsërit me dy albumet e tjera; *Bryter Later* më 1971 *Pink Moon* më 1972. Kishte publicitet të kufizuar dhe

refuzimi përfundimtar për koncerte nuk ndihmoi aspak. Performanca e tij e fundit ishte në vitin 1970 dhe ai mbajti pak më shumë se 30 koncerte gjatë gjithë karrierës. “Ishin vetëm dy ose tri koncerte që ndiheshin mirë; kishte diçka që nuk shkonte me gjithë të tjerët”, tha ai në njërin nga ato dy intervista për shtyp – më 1971, për revistën *Sounds*. E kishte producentin e famshëm Joe Boyd, ndërsa në grupin Velvet Underground ishte John Cale. Që të dy kishin këmbëngulur të punojnë me të, por kot. Drake u dëshpërua rëndë dhe u kthye të jetonte te prindërit e vet, duke i thënë nënës: “Kam dëshuar në çdo gjë që kam provuar të bëj”. Vizitoi psikiatrin, i kaloi pesë javë në një institucion psikiatrik dhe madje u trajtua me terapi elektrokonvulsive.

Në mëngjesin e 25 nëntorit 1974, u gjet i vdekur në dhomën e gjumit. Një shishe që mbante rreth 60 hapa kundër depresionit, të dhëna me recetë, u gjet bosh pranë tij. Patologu gjeti provat e një “mbidoze të rëndë”. Dhe, ky mund të ketë qenë fundi i historisë së Nick Drakeit.

Por, siç raporton Morton Jack, brenda dy viteve nga vdekja e tij, diçka e papritur nisi të ndodh. Shenja e parë ishte kur një grua 21-vjeçare amerikane nisi të telefonojë në shtëpinë e tij, në mars të vitit 1976. E kishte blerë albumin *Pink Moon* në një dyqan diskografik në Hjuston të Teksasit dhe donte të zbulonte

gjithçka që mundte për artistin misterioz. Për këtë ajo madje udhëtoi në Angli. Nëna dhe babai i Nickut e ftuan brenda dhe e lanë të bunte aty. Ajo ishte e para nga shumë adhurues të flaktë që do ta bëjnë të njëjtin pelegrinazh, kështu që reputacioni i Nickut u rrit dhe u rrit. U publikuan albume përmbledhëse dhe artistët e mëdhenj si REM, Kate Bush dhe Everything But the Girl e përmendnin si frymëzim. Pas reklamës së VW-së, sipas librit të gazetares amerikane Amanda Petrusich – të vitit 2007, për *Pink Moon* – shitjet e albumit “u rritën gati 500 për qind gjatë 10 javëve të para të vitit 2000”. *New York Times* raportoi më 2001 se shitjet ishin rritur nga rreth gjashtë mijë kopje në vit në më shumë se 74 mijë.

Pra, Drake doli nga errësira e gjatë jetës, duke u paraqitur në kopertinat e revistave muzikore, duke qenë subjekt i një dokumentari të *Radio 2* të prezantuar nga Brad Pitt, dhe muzika e tij shfaqej në filmat e njohur të Hollivudit si *A Beautiful Day in the Neighbourhood* dhe në hitet televizive si *Normal People*. Madje, një birrë quhet sipas një kënge të tij.


Muzikanti Paul Weller, komediani Sue Perkins, mikrobiologjia Sharon Peacock dhe shkrimtari i shquar xhamajkan Marlon James, janë ndër të ftuarit që kanë zgjedhur këngët e tij në programin *Desert*

Island Discs të *Radio 4*. James tha se ai vuri diskun e tij në pajisjen muzikore në vitin 1993 dhe nuk e hoqi deri në vitin 1998: “E kam lëshuar pothuajse çdo natë ... sa herë që e dëgjon, është një fantazmë në dhomë.”

Emeli Sandé është ndër artistet në albumin e ri përmbledhës, me versionin e këngës *One Of This Things First*. Tha se beson se popullariteti i Nickut ka vazhduar të rritet “për shkak të pastërtisë në muzikë dhe gjithashtu të thellësisë. Tekstet e tij janë poezi. Mendoj se janë vërtet të përjetshme. Pa marrë parasysh sa herë ktheheni dhe i dëgjoni, gjeni diçka të re”.

The Endless Colored Ways e ka marrë titullin nga një varg në *From the Morning*, një këngë në *Pink Moon*. Disa adhurues i shohin këngët si dëshmi e gjendjes së tij të përkeqësuar mendore: Richard Thompson i grupit Fairport Convention, i cili ka interpretuar në disa pika në albumet e mëparshme, u “shqetësua” kur e dëgjoi LP-në. “Mu duk si thirrje për ndihmë. Zëri i një njeriu që zhytet në kufirin e mendjes së shëndoshë”, ka shkruan ai në librin e tij të kujtimeve të vitit 2021, *Beeswing*. Guri i varrit të Nickut përmban vargjet e tij nga *From the Morning*: “Tash çohemi dhe jemi kudo”. Ajo që ka synuar me këtë varg mund të jetë e pasigurt, por sigurisht se është e vërtetë për adhuruesit e tij. /Telegrafi/

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Kosova i zhvillon dy miqësore me Lihtenshtajnin

PRISHTINË, 7 KORRIK, 2023 - Përfaqësuesja e Kosovës për femra në futboll do t'i zhvillojë dy ndeshje miqësore gjatë këtij muaji kundër Lihtenshtajnit, në kuadër të përgatitjeve për edicionin e parë të Ligës së

Kombeve që fillon garat në shtator. Futbollistet "dardane" më 13 korrik dhe më 16 korrik do të përballen me Lihtenshtajnin. Të dy ndeshjet do të zhvillohen në Kampin Nacional në Hajvali, e para në

orën 18:30, e dyta në orën 11:30. Përzgjedhësja Anneli Andersen për këto dy miqësore ka ftuar 24 futbolliste, të cilat do t'i ketë në dispozicion që nga 10 korriku,

kur do të mbahet edhe stërvitja e parë në Hajvali në orën 16:00. Ndeshjen e parë në kuadër të Ligës së Kombeve Kosova do ta luajë në shtator kundër Bullgarisë. Dardanet janë pjesë




e Ligës C në Grupin 5, ku bën pjesë edhe Maqedonia e Veriut.

Ndeshjet Ballkani - Ludogorets dhe Dukagjini - Europa zhvillohen në stadiumin 'Fadil Vokrri'

"Epoka e re"

PRISHTINË, 7 KORRIK - Federata e Futbollit e Kosovës ka njoftuar opinionin se dy ndeshjet e para të klubeve të Kosovës për edicionin e ri të garave evropiane do të zhvillohen në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Pas monitorimit dhe vlerësimit të fushës nga eksperti i UEFA-s, u vendos që ndeshja Ballkani - Ludogorets, në kuadër të rrethit të parë të kualifikimeve për Ligën e Kampionëve, më 11 korrik, dhe Dukagjini - Europa, në kuadër të Ligës së Konferencës, më 13 korrik, të zhvillohen në stadiumin "Fadil Vokrri". Pas këtyre dy ndeshjeve, eksperti i UEFA-s së bashku me ekipin e mirëmbajtjes së stadiumit do të punojnë për t'u rikuperuar edhe më tutje fusha, e cila ka pësuar dëmtime kohët e fundit. FFK-ja fton klubet të përkujdesen maksimalisht për në ruajtjen e

fushës dhe kësaj stërvitjet zyrtare t'i zhvillojnë në ndonjë stadium tjetër ose në Kampin Nacional në Hajvali në mënyrë që fusha të mos dëmtohet më shumë. "Duke pasur parasysh se në këtë periudhë është e pamundur të intervenohet për ndërrimin e barit dhe as në zëvendësimin e tij, dhe meqenëse në këtë stadium do të zhvillohen edhe ndeshjet zyrtare të Kombëtares A, Kombëtares U21 dhe të Kombëtares së vajzave, është e nevojshme që fusha të jetë sa më pak e ngarkuar në gjendjen aktuale. Në këtë rast, FFK i fton tifozët dhe opinionin t'i përkrahin skuadrat tona në këto ndeshje dhe të jenë në numër sa më të madh në tribunat e stadiumit 'Fadil Vokrri'. Për ta siguruar suksesin e skuadrave tona, nevojitet mbështetja dhe entuziazmi i tyre gjatë këtyre ndeshjeve", thuhet në njoftimin e Federatës së Futbollit të Kosovës. FFK-ja do ta vazhdojë të



monitorojë gjendjen e fushës dhe t'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për ta rikuperuar

atë sa më mirë. "Shpresojmë që skuadrat tona të na dhurojnë emocione dhe të hedhin hap të

rëndësishëm drejt kualifikimit tutje", thuhet në njoftimin e FFK-së.

Evropiani në Prishtinë, sot zhvillohen katër ndeshje



PRISHTINË, 7 KORRIK - Çdo gjë është gati për Kampionatin Evropian për hendbollistet deri në 19 vjet, i cili nga e shtuna deri më 16 korrik mbahet në Prishtinë. Ndeshjet do të luhen në Pallatin e Rinisë dhe Sportit në kryeqytet, ndërsa FHK-ja i ka bërë të gjitha përgatitjet që Evropiani ta ketë rrjedhën e duhur. Marrin pjesë hendbolliste nga nëntë ekipe kombëtare. Kombëtares janë të ndara në dy grupe. Në Grupin

A janë Sllovakia, Italia, Finlanda, Kosova dhe Britania e Madhe. Në Grupin B bëjnë pjesë Austria, Polonia, Letonia dhe Izraeli. Në kuadër të Grupit A të shtunën prej orës 12:15 është ndeshja Finlanda - Britania e Madhe. Sllovakia e Kosova takohen prej orës 19:30. Një orë më herët është hapja zyrtare e Kampionatit Evropian të Divizionit të Dytë. Në Grupin B, Austria e Letonia luajnë prej orës 14:30.

Ndërkohë Polonia e Izraeli përballen prej orës 16:45. Ndeshjet e para pritet të dëshmojnë forcën e vërtetë të ekipeve kombëtare dhe janë me rëndësi të madhe. Kombëtarja e Kosovës është përgatitur për kohë të gjatë në Gjakovë e Prishtinë, ndërsa ka pasur edhe dy ndeshje kontrolluese me Bullgarinë. Në shtabin teknik vlerësojnë se vajzat janë gati për ta shfaqur më të mirën e mundshme.

Xhaka: Leverkusenin e zgjodha për shkak të historisë dhe ambicieve

LEVERKUSEN, 7 KORRIK - Mesfushori Granit Xhaka është lojtar i Bayer Leverkusenit. 30-vjeçari shqiptar është rikthyer në Gjermani. Ai ka luajtur edhe më parë me Borussia Munchengladbachun. Xhaka mbylli një karrierë 7-vjeçare me Arsenalin, i cili ishte një ndër liderët e këtij grupi. Pas

rikthimit në Bundesliga, ai ka thënë se e zgjodhi Leverkusenin pasi është një klub i madh dhe ka ambicie të mëdha. "E njoh mjaft mirë këtë kampionat si brenda ashtu edhe jashtë tij, pasi kam luajtur më parë aty, por edhe për faktin se e kam ndjekur gjithnjë edhe kur isha në Londër. Bayer është një klub

me histori të madhe dhe që ka objektiva ambicioze për të ardhmen. Një gjë është e sigurt, që ka një të ardhme të madhe. Bisedimet që pata me drejtuesit e këtij klubi më motivuan edhe më shumë për të ardhur këtu", ka thënë Xhaka. Pas transferimit të Xhakës në Bundesliga tek ekipi i Bayer Leverkusenit me

të cilin ka nënshkruar marrëveshje deri në vitin 2028, "topçinjtë" e falënderuan atë për kontributin. Ai pati 297 paraqitje, duke shënuar 23 gola dhe duke i bërë 29 asistime. Me Arsenalin, Xhaka arriti t'i fitojë dy trofe të FA Cup. 30-vjeçari deklaroi se përherë do të jetë "pjesë e



familjes së Arsenalit". Kalimi i tij te Leverkuseni u bë edhe nga klubi gjerman.

Dhjetë trajnerët më të mirë në botë në sezonin e fundit

Madrid, 7 korrik - Mediumi i njohur ESPN ka renditur dhjetë trajnerët më të mirë në botë në sezonin 2022/23. Listës i prin Pep Guardiola i Manchester Cityt. Përfundimi i sezonit të rregullt në botën e futbollit ka bërë të ketë ndryshime në

renditjen e trajnerëve më të mirë. Fitimi i tre trofeve nga Manchester City ka bërë që Guardiola ta marrë fronin si trajneri më i mirë i sezonit 2022/23. Guardiola ka lënë pas vetes trajnerin e Real Madridit, Carlo Ancelottin, ndërsa

podiumi plotësohet nga Luciano Spalletti, i cili fitoi titullin e Serisë A me Napolin. Në vendin e katërt është renditur Mikel Arteta i Arsenalit, në të pestin Jurgen Kloppi i Liverpoolit, ndërsa në vendin e gjashtë Lionel

Scaloni i Argjentinës. Vendi i shtatë është rezervuar nga Erik ten Hag i Manchester Unitedit, i teti nga Roberto De Zerbi i Brighton, i nënti nga Simone Inzaghi i Interit dhe Xavi i Barcelonës mbyll top dhjetëshen.



Reus: Kam vendosur të heq dorë nga shiriti i kapitenit

Dortmund, 7 korrik - Legjenda e Borussia Dortmundit, Marco Reus, ka vendosur t'i japë fund periudhës së tij pesëvjeçare si kapiten i klubit verdhezi dhe ta dorëzojë shiritin përpara sezonit të ri në Bundesliga. Pavarësisht se kjo ndodhi më shumë se një muaj më parë, nuk do të habiteshim nëse disa lojtarë dhe tifozë të Dortmundit zgjohen ende natën nga ankthet e ditës së fundit të sezonit të kaluar. E gjithë bota mendonte se Dortmundi do t'i jepte fund një dekade dominimi të Bayern Munichut në Bundesliga, duke shkuar në ndeshjen e fundit të sezonit përpara rivalëve të tyre. Megjithatë, fatkeqësia goditi Dortmundin pasi Bayerni fitoi titullin e 11-të radhazi, duke i lënë rivalët e tyre në lot pas përfundimit të ndeshjes. Një nga ata lojtarë që ka vuajtur veçanërisht është kapiteni i ekipit, Reus, i cili ka qenë në klub që nga viti 2012, duke iu bashkuar klubit pas fitimit të titullit të fundit. Tashmë gjermani ka vendosur që sezonin e ardhshëm



të luajë pa shiritin e kapitenit, siç mund të shihet në deklaratën e tij në videon e mëposhtme. "Përhëndetje tifozë të BVB. Është shumë e rëndësishme për mua t'ju them diçka personalisht. Kam pasur shumë për të menduar gjatë pushimeve të mia dhe kam vendosur ta heq shiritin e kapitenit. Për këtë i kam informuar Edin Terzic dhe Sebastian Kehl, të cilët më lejuan ta mbaj këtë shirit për pesë vjet me krenari dhe nder. Faleminderit për mbështetjen

gjatë këtyre viteve! Uroj që Sebastian dhe Edin të gjejnë një pasardhës të mirë. Jam i sigurt se do t'ia dalin", ka thënë Reus në faqen zyrtare të klubit. Reusit iu dha shiriti fillimisht nga trajneri Lucien Favre në fillim të sezonit 2018/19 dhe e ka mbajtur atë që atëherë. Në prill ai nënshkroi një zgjatje njëvjeçare të kontratës së tij që do të thotë se do të skadojë verën e ardhshme dhe ky mund të jetë fundi i kohës së tij në "Signal Iduna Park".

Operohet Antetokounmpo, rrezikon Botërorin me Greqinë

MILWAUKEE, 7 KORRIK - Basketbollisti i Milwaukee Bucks, Giannis Antetokounmpo, është operuar në gjurin e majtë. Ai rrezikon të mos jetë me kombëtaren e Greqisë në botërorin që nis më 25 gusht, duke qenë në pikëpyetje edhe për fillimin e sezonit të ri të NBA-s. Sipas medieve amerikane, Giannis ka marrë së fundi "OK" e stafit mjekësor të Bucksit për t'u operuar, për të qenë në kohë për nisjen e sezonit të ri. Gjithsesi, klubi ka qenë në dyshim për të luajtur me kombëtaren helene, nga frika se mos dëmtimi rikthehet e rrezikon një ndalesë më të gjatë. Një gjë është e sigurt, se Antetokounmpo nuk ka për të qenë në formën optimale nëse shkon në botëror dhe rrezikon shumë me një gju të operuar. Por ai dëshiron ta dërgojë Greqinë në Olimpiadën e Parisit, ndaj është



gati të sakrifikojë. Në Evropianin e fundit ai pati një mesatare prej 29.3-pikësh për ndeshje me kombëtaren. Mediet sqarojnë se operacioni në gju nuk ka qenë i vështirë, madje një "operacion rutinë", por gjuri kërkon një

periudhë të caktuar pushimi. Greku, dy herë MVP i NBA-së dhe me një titull kampion me Milwaukee, vjet pati disa shqetësime me gjurin, duke luajtur 63 nga 82 ndeshjet e sezonit të rregullt.

SHKURT

Dabiqaj transferohet te Drita

Tanimë është zyrtare dhe e konfirmuar që Albert Dabiqaj është lojtari më i ri i Dritës. Lajmin e ka konfirmuar vetë skuadra e Dritës, duke njoftuar për transferimin e Dabiqajt përmes një videoje në "Facebook". Po ashtu, Drita ka njoftuar se Dabiqaj do ta mbajë numrin 14 në fanellë. Para këtij transferimi Dabiqaj ishte pjesë e rivalit të përbetuar të Dritës, Gjilanit, me të cilin kaloi plot dy vjet, duke shënuar 16 gola dhe duke bërë gjashtë asistime në 63 ndeshje të zhvilluara.

Verstappen: Dëshirojmë t'i fitojmë të gjitha garat

Gara e fundit në Austri tregoi se Max Verstappen nuk dëshiron t'u lërë asgjë rivalëve të tij, madje as thërmijat. Dëshira për të marrë edhe pikën e xhiros së shpejtë bëri që kampioni i botës në Formula 1 të hyjë në bokse dhe ta realizojë atë, duke ia hequr atë pikë shokut të tij të skuadrës. Në prag të garës së Silverstones, që zhvillohet këtë fundjavë në Angli, piloti holandez i Red Bullit ka thënë: "Si skuadër dëshirojmë t'i fitojmë të gjitha garat e këtij sezoni. Ky është një objektiv i mundshëm, por jo i lehtë për t'u arritur. Ka ende shumë gara për t'u zhvilluar, ndërkohë që një gabim mund të ndodhë dhe të humbas". Dy herë kampioni i botës ka arritur në kuotën e 42 fitoreve në Formula 1, në një moshë që të tjerët nuk e imagjinonin dot. "Jam krenar për këto shifra, pasi nuk e kisha imagjinuar kurrë. Për sa kohë ke fatin me vete si dhe një makinë kompetitive është normale që të arrish këto rezultate me kaq shumë gara", ka deklaruar Verstappen.

Arda Guler: Zgjedha ekipin më të madh në botë

Arda Guler është paraqitur të premten si futbollist më i ri i Real Madridit. Ai u zyrtarizua të enjten, teksa Real Madridi ia "vodhi" futbollistin turk Barcelonës. Katalonasi ishin shumë pranë arritjes së marrëveshjes, megjithatë Reali hyri në garë dhe siguroi shërbimet e tij. E në prezantim, Arda Guler tha se zgjodhi të shkonte në klubin më të madh në botë. "Shumë klube më dëshiruan, por vendosa t'i bashkohem Real Madridit. Ky është klubi më i madh në botë", ka thënë Arda Guler.

Al Ahli e kërkon me ngulm Manen

Klubi nga Arabia Saudite, Al Ahli, e kërkon me ngulm sulmuesin senegalez Sadio Mane. Ditët e ardhshme ekipi arab do t'i ofrojë atij një kontratë trevjeçare. Sadio Mane është prioriteti aktual i Al Ahlit. Sezonin e kaluar Mane ishte pjesë e Bayern Munchenit, ndërsa rritjen më të madhe e pati sa ishte pjesë e Liverpoolit. Tek Al Ahli ai mund ta gjejë ish-bashkëlojtarin e tij të dikurshëm te "Reds", Roberto Firmino.

Liverpooli ofron 200 milionë euro për Mbappen

E ardhmja e Kylian Mbappe vazhdon të jetë e paqartë. Sulmuesi ka bërë me dije se nuk ka ndërmend ta rinovojë kontratën me PSG-në që i skadon qershorin e ardhshëm dhe klubi duhet ta shesë për të mos e humbur me kosto zero

pas një viti. Për kampionin e botës interesohet prej kohësh Real Madridi, por duket se tani është futur në garë edhe një klub tjetër. Sipas Edu Aguirre, gazetar i El Chiringuito, Liverpooli duket se është gati të bëjë

çmenduri për ta marrë kampionin francez. Në fakt, flitet për 200 milionë euro; ofertë marramendëse për t'i dhuruar Jurgen Kloppit një lojtar që mund t'i ndryshojë plotësisht ekuilibrat e Premierë Ligës në sezonin e ardhshëm.

Të Kuqtë, pas vështirësive të sezonit të kaluar, synojnë të kthehen në luftë për titullin dhe është e qartë se me një lojtar si Mbappe shanset për ta fituar titullin janë shumë më të mëdha. Problemi mund të jetë Evropa.

Liverpooli, siç dihet, do të luajë në Evropa Ligë dhe ka shumë mundësi që Mbappe të dojë të qëndrojë në Ligën e Kampionëve, gjë që ia ofron një ekip si Real Madridi. Situata Mbappe mund të zhblokohet nga një moment në tjetrin.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "ON Architecture" SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811418187 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "ON Architecture" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811418187 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "ON Architecture" L.L.Chas come to the decision to quit its business: 811418187 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- "N.T.SH. Universal AB" shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330245614.

- Dafina Robaj shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës së mesme të mjëksisë "Dr. Ali Sokoli" Prishtinë nga viti I, II, III, IV.

- Valon Bilalli shpall te pavlefshme 4 dëftesa , certifikatën , diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Belinda Aliu shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu "Lekë Dukagjini" Prizren.

- Gezim Elshani shpall të pavlefshme 3 dëftesa dhe diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Taulant Mejzini nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hjadar Dushi" Gjakovë.

- Daut Rexhaj nga Gramaqel KK Decan Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Vëllaznim Rraci nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Daut Husi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Altin Kamberi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hjadar Dushi" Gjakovë.

- Nexhat Meholli, shpall te pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "TREPÇA".

Leutrim Shehi shpall te pavlefshme 1 dëftesë dhe diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Erkan Gashi shpall te pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Bekim Hoti shpall te pavlefshme 4 dëftesa dhe diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

